



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3247/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, 73, Udhëzimin Administrativ Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e komiteteve Konsultative në Komuna neni 4, 8 paragrafi 3, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 30, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2022 merr:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E LISTËS PËR TRI KOMITETET KONSULTATIVE

1. Kuvendi i komunës miratoj vendimin për listën e tri komitetet konsultative të përzgjedhura nga paneli intervistues. Lista e tri komiteteve konsultative do të përfaqësohet me nga pesë anëtarë siç vijon:

- 1.1. Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit
- 1.2. Komiteti për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe
- 1.3. Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë

2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi lista e tri komiteteve konsultative do të ketë këtë përbërje:

Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka këtë përbërje:

1. Shaban Çupi
2. Ziber Xhoni
3. Samire Curri
4. Vlora Bela
5. Arta Vila

Komiteti Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit ka këtë përbërje:

1. Melihate Krenzi Laçi
2. Zekije Lusnjani
3. Imer Lusnjani
4. Nesrine Kalisi
5. Saxhid Thaçi

Komiteti Konsultativ për Shërbime Publike dhe Emergjencë ka këtë përbërje:

1. Shahadije Laçi
2. Sara Axhami
3. Tahir Curri
4. Gani Krasniçi
5. Medin Kalisi

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e Komiteteve Konsultative,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.05.2022





Republika e Kosovës - Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 3264 /2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.08/L-066) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 31.05.2022 merr:

VENDIM

PËR TRANSFERIN E MJETEVE NGA REZERVA KOMUNALE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për transfer të mjeteve nga kategoria ekonomike rezerva në shpenzime kapitale.
2. Nga Nën-Programi Buxhetor – Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve 18444 kodi funksional 180 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 GQ, shuma prej 5,000.00 €,

Transferohet: Në Nën-Programin Buxhetor – Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve 18444 kodi funksional 180 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital “Ndriçimi publik në zonat urbane dhe rurale” me kod 90573, shuma 5,000.00 €.

3. Nga Nën-Programi Buxhetor – Shërbimet e Shëndetësisë Primare 75050 kodi funksional 730 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 GQ, shuma prej 5,000.00 €.

Transferohet: Në Nën-Programin Buxhetor – Shërbimet e Shëndetësisë Primare 75050 kodi funksional 730 në kategorinë Shpenzimet Kapitale, në projektin kapital, “Rregullimi i infrastrukturës në QKMF (Rregullimi i nxemjes)” me kod 51024 në shumë prej 5,000.00 €.

4. Nga Nën-Programi Buxhetor – Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66480 kodi funksional 660 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale, fondi burimorë 21 GQ, shuma prej 5,000.00 €.

Transferohet: Në Nën-Programin Buxhetor - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66480 kodi funksional 660 në kategorinë Shpenzimet Kapitale nga Rezerva komunale në projektin kapital, “Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale në Han të Elezit” me kod 48910 në shumë prej 5,000.00 €.

5. **Të transferohen mjetet nga Rezerva e nën-programit:**

Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarreve 18444 , shuma prej 5,000.00 € për vitin 2022,
Shërbimet e Shëndetësisë Primare 75050, shuma prej 5,000.00 € për vitin 2022,
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni 66480, shuma prej 5,000.00 € për vitin 2022.

6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Formularët standard nga MFPT të plotësuar me shumat e lëvizura sipas Nën-Programeve buxhetore dhe kodeve ekonomike të shpenzimeve.
7. Për realizimin e këtij vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.
8. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 31.05.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.3640/2022

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 08/L-066 për vitin 2022, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë neni 27, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datën 31.05.2022 merr:

V E N D I M

PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/Nr.2755/2022 PËR BARTJEN E MJETEVE TË PASHPENZUARA TË TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE NGA VITI 2020 DHE 2021 NË VITIN 2022

1. Kuvendi i komunës miratoi plotësim ndryshimin e vendimit me numër 01/Nr.2755/2022 për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2020 dhe 2021 në vitin 2022.
2. Të hyrat e bartura nga viti 2020 në vitin 2021 kanë qenë në shumën prej **57,779.88 €**, prej tyre janë shpenzuar në shumën prej **57,001.74 €**, kurse për bartje kanë mbetur edhe **778.14 €**. Të hyrat vetanake të realizuara gjatë vitit 2021 kanë qenë në shumë prej **325,140.90 €**, prej tyre janë të shpenzuara **253,181.28 €**. Pra në total, të hyrat vetanake të pa shpenzuara të vitit 2020 dhe 2021 janë në shumën prej **72,737.76 €**, të cilat i bartim për vitin 2022.
3. Këto mjete sipas pikës 2 në shumë prej **72,737.76 €**, i shpërndajmë nëpër këto kategori ekonomike të shpenzimeve, si vijon:
 - mallra dhe shërbime në shumë prej **21,800.00 €**,
 - subvencione dhe transfere në shumë prej **7,000.00 €** dhe
 - shpenzime kapitale në shumë prej **43,937.76 €**.
4. Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime në shumë prej **21,800.00 €**, në nën-programet si vijon:
 - Administrata (16335), kodi funksional (0133), shuma prej **2,500.00 €**,
 - Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620), në shumë prej **9,671.27 €**,
 - Shërbimet e Shëndetësisë Primare (75050), kodi funksional (0721) shuma prej **7,226.15 €**,
 - Arsimi Parafillor Çerdhja (92890), kodi funksional (0911), shuma prej **2,337.58 €**,
 - Arsimi i mesëm (95220), kodi funksional (0922), shuma prej **65.00 €**.

5. Në kategorinë ekonomike Subvencione dhe transfere në shumë prej **7,000.00 €**, në nën-programin, si vijon: Zyra e kryetarit (16035), kodi funksional (0111) shuma prej **7,000.00 €**.
6. Në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale në shumë prej **43,937.76 €** në nën-programet dhe në projektet, si vijon:
- Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), në projektet:
- “Gjellbërimi i disa hapsirave publike”, kodi (41640) shuma prej **18,000.00 €**.
- “Rregullimi i parkut në rrugën "Isa Berisha"(asfaltim, trotuar, ndriçim publik, gjellbërim) " kodi (51085) shuma prej **22,437.76 €**.
- Shërbimet e shëndetësisë primare (75050) në projektin :
- „Rregullimi i infrastrukturës në QKMF (Rregullimi i nxemjes) kodi (51024) shuma prej **3,500.00 €**
7. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorët e Drejtorive,
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data : 31.05.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta

